



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
ME JURIDIKSION TË PËRGJITHSHËM
SARANDË**

A N A L I Z Ë

**E TREGUESVE KRYESORË TË PUNËS PËR VITIN 2017
NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
ME JURIDIKSION TË PËRGJITHSHËM
SARANDË**

**DREJTUAR:
PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
ZJ.ARTA MARKU
TIRANË**

I nderuar z.Prokuror i Përgjithshëm!

Në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në:

-*Ligjin Nr.76/2016*, datë 22.07.2016 “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8417, DATË 21.10.1998, KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (të ndryshuar)”, PJESA E DHJETË, Neni 148/1/2/3 dhe Neni 148/b, gërma “dh”

-*Ligjin Nr.97/2016*, datë 06.10.2016 “PËR ORGANIZMIN DHE FUNKSIONIMIN E PROKURORISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, Neni 50/2

-*Urdhërat dhe Udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm* lidhur me raportin vjetor të Drejtuesit të Prokurorisë dhe përmbajtjen e tij;

në përfundim të periudhës së ushtrimit të funksioneve ligjore përgjatë vitit parardhës (01.01.2017 deri 31.12.2017) ju paraqesim këtë “Raport Vjetor” të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm Sarandë me arritjet dhe objektivat e realizuar gjatë ushtrimit të ndjekjes penale në fazën e hetimit paraprak dhe në gjykim, kryerjen e detyrimeve të tjera të parashikuara në ligj nga prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe administrata e institucionit, si dhe analizën me treguesit sasiorë e cilësorë në përgjithësi, por dhe në veçanti për secilin prej tyre.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm Sarandë ushtron funksionet në bazë të kompetencave ligjore, në një territor që përfshin:

- 1- *Bashkinë Sarandë*
- 2- *Bashkinë Delvinë*
- 3- *Bashkinë Finiq*
- 4- *Bashkinë Konispol*
- 5- *Bashkinë Himarë* (pjesërisht).

Territori ku ushtron kompetencën tokësore ky institucion përfshin një sipërfaqe dhe numër popullsie të konsiderueshëm, vazhdimisht në rritje. Ka lëvizje të shumta të njerëzve dhe mjeteve me destinacion sidomos fqinj të jugor, Greqinë, gjithashtu me dinamikë të konsiderueshme, ndërkohë që në periudhën e verës rritja është tepër e ndjeshme për shkak se zona ofron resurse turistike nga më të mëdhatë në vend. Ndryshimi i hartës territoriale, ku tashmë Njësia Administrative e Lukovës është pjesë e Bashkisë Himarë dhe mospërshtatja e legjisllacionit të ri ka krijuar **konfuzion për kompetencën tokësore** pasi tashmë pjesë të “ish-Rrethit të Sarandës”(struktura “Rreth” praktikisht nuk ekziston më) janë brenda kësaj njësie administrative, madje dhe zona shumë pranë të qytetit të Sarandës, me orientim administrativ në Bashkinë Himarë. Në këto rrethana është vepruar mbi bazën e praktikës shumëvjeçare, deri më tani janë evituar problemet, për shkak të zotimit tonë profesional, por kjo situatë mbetet për t’u zgjidhur në interes të punës dhe komunitetit.

Gjatë vitit 2017 janë trajtuar **një numër i madh çështjesh**, materiale kallzuese, procedime, çështje të mbartura apo të rifilluara, si ato me përparësi dhe më problematike për komunitetin e gjerë, por dhe të tjera në ushtrim të funksionit, ndërsa ka patur një aktivitet të konsiderueshëm dhe në përfaqësimin në gjykim, ekzekutimet e vendimeve dhe marrdhëniet juridiksionale me shtetet e huaja. Në këtë kontekst do të veçonim veprimtarinë që lidhet me grupin e veprave penale kundër personit (krimet kundër jetës e shëndetit, krimet seksuale, veprat penale kundër fëmijëve, martesës e familjes), grupin e veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike dhe krimet kundër autoritetit të shtetit.

Në këtë kuadër, duke zbatuar detyrimin kushtetues si autoriteti i vetëm për ushtrimin e ndjekjes penale, kemi qenë të zotuar për të kryer një hetim sa më të plotë dhe të gjithanshëm për të gjitha procedimet e trajtuara gjatë këtij viti, për të ngritur dhe përfaqësuar sa më mirë akuzën në gjykim, për të ekzekutuar në kohë vendimet penale të gjykatave dhe për të mbikqyruar në vazhdimësi vuajtjen e dënimit. Nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, seksioni pranë kësaj Prokurorie, ka patur gjerësi veprimi, cilësi e seriozitet me rezultate të dukshme, në këto aspekte konkrete:

- vlerësimi i materialeve dhe arritja në një konkluzion të bazuar për mundësinë e rregjistrimit ose jo të procedimit penal
- hetimi profesional dhe në një kohë të arsyeshme
- komunikimi korrekt me palë, subjekte apo të interesuar
- përfaqësimi korrekt dhe dinjitoz në seanca gjyqësore
- veprimi i shpejtë dhe efikas në procesin e ekzekutimit
- raporte korrekte, të shpejta dhe efikase me zyrat përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme, por dhe institucionet e tjera

-I-

Në veprimtarinë hetimore është ngritur në një nivel më të lartë *respektimi i të drejtave të njeriut, trajtimi i rasteve me të mitur dhe grupet vulnerabël ku do të veçonim disa aspekte konkrete:*

Prokurorët (kur ka qenë e nevojshme dhe oficerët e policisë gjyqësore) *janë prezent* në rastet e kufizimeve të lirisë që në momentet e para (pothuasje në të gjitha rastet), në veçanti dhe me impenjim maksimal në rastet e fakteve komplekse apo që lidhen me vepra të rënda penale. Kjo ka dhënë dhe rezultatet konkrete si në zbardhjen e ngjarjeve dhe në vlerësimet faktike nga gjykata në procese. Pavarësisht se nuk ndjekim *çështjet me të mitur*, në të gjithë procedimet (kuptohet që është proceduar më tej me moskompetencë) vlerësimi i rasteve nga prokurorët ka qenë maksimal, ndërsa nuk ka raste të dështimeve në çështjet për shkak të shkeljeve që lidhen me të drejtat e njeriut (respektohet procesi i drejtë, pjesëmarrja e mbrojtjes apo të pranishmëve të tjerë që detyron ligji etj.). Rastet e *të dëmtuarit në procesin penal* trajtohen me seriozitet; komunikimi zyrtar dhe me personat ka qenë korrekt dhe në përmirësim të vazhdueshëm.

Në raport me vitin e mëparshëm, duke patur një kujdes më të madh janë bërë përpjekje maksimale për vlerësimin dhe trajtimin e rasteve në një kohë sa më të shkurtër dhe uljen e kohës së paraburgimit. Kjo praktikisht rrit *numrin e mosfillimeve* dhe sjell ngarkesë më të madhe, sidomos për prokurorët, për shkak të ngushtimit të hapësirave kohore për daljen me vendim përfundimtar, por ka ndikuar në përmirësimin e imazhit dhe vlerësimeve pozitivisht në kohë pa ndikuar në cilësinë, ndërsa është përmirësuar procedura e njoftimit.

Kanë qenë shqetësuese *rastet me ekspertimet* duke ndikuar negativisht në zgjatjen e afateve të hetimeve e më tej ato të paraburgimeve, por që praktikisht duket se janë drejt normalizimit. Këtu ka ndikuar dhe ulja e veprave penale sipas Neneve 283 e 284 të K.Penal në nivel kombëtar që krijoi ngarkesë të përgjithshme, por dhe në këtë territor, ndërsa problem specifik ketu mbetet *zhvendosja e shpesh të drejt spitalëve në Tiranë të personave të dëmtuar në veprat apo faktet e dyshuara si penale.*

Bashkëpunimi ndërinstucional ka qenë në nivele shumë të mira, *bashkëpunimi ndërkombëtar* gjithashtu, megjithëse pritet më shumë për rastet në hetim ku vonesa e informacionit krijon zvarritje. Kemi patur raste të kontakteve me autoritetet greke për evidentimin e personave me veprimtari të paligjshme në të dy vendet, madje dhe rezultate në çështje konkrete. Mbetet punë për të bërë lidhur me përdorimin e metodave speciale hetimore dhe *hetimet proaktive, por ka rritje të dukshme.* Kjo lidhet dhe me specifika të rrjedhës së veprimtarisë, reagimit të publikut apo dhe spontanitetit, por besojmë që ndryshimet e reja ligjore do të japin më tepër hapësirë dhe pavarësi dhe në pjesën e inicimit të hetimeve nga prokurorët.

Në vitin 2017 janë ushtruar *funksionet ligjore* dhe ato që burojnë nga *urdhërat e udhëzimet.* Konstatohet një rrjedhë pozitive, pavarësisht problematikave, në dobi të punës, kjo në kuadrin e një komunikimi e bashkëpunim të vazhdueshëm të vendosur mes drejtuesit e prokurorëve nga njëra anë dhe drejtuesve e shërbimeve të policisë gjyqësore nga ana tjetër. Niveli i bashkëpunimit ka patur dhe rezultate konkrete, të dukshme veçanërisht *në zbardhjen e ngjarjeve me pasoja të rënda a fatale.* Ka vlerësim e mobilizim tepër pozitiv nga këto struktura, por mbeten ende një sërë problemesh, zgjidhja e të cilave do të përmirësonte më tej punën ku do të përmendim:

- *plotësimi i kuadrit ligjor* që lidhet me veprimtarinë e policisë gjyqësore dhe shërbimeve
- *lëvizjet e shumta dhe të shpeshta* në organikën e shërbimeve të policisë gjyqësore
- *mangësitë numerike, profesionale* dhe në përvojë konkrete të elementevë të kësaj organike
- *problemet e infrastrukturës* dhe ato që lidhen direkt me to

Në zbatim të frymës së re kushtetuese dhe detyrimeve të reja ligjore, po merren masat për krijimin e një raporti të drejtë të mënyrës së funksionimit, në përshtatje me të, pavarësisht mangësive dhe faktit që ka ende nevojë për plotësimin e kuadrit ligjor. Në vazhdimësi shpresojmë dhe në përmirësimin e bashkëpunimit me institucione të tjera, përfshi dhe *shërbimin informativ* në kushtet kur territori ku ushtrojmë funksionet ndodhet në kufirin midis shteteve dhe ka ndikim në raportet tona me fqinjët, komunitetin ndërkombëtar dhe për më tepër në kuadrin e integritit kombëtar drejt familjes europiane. Parandalimi dhe goditja më e mirë e veprimtarisë së paligjshme në territor padyshim krijon premisa pozitive me ndikim evident e të drejtpërdrejtë në këtë fushë. Praktikisht ka përmirësim në këtë aspekt, përfshi dhe reagimin e institucioneve, ndërsa mbetet problem situata me shërbimet shtetërore dhe *kallzimet formale* të institucioneve që krijojnë një ngarkesë formale.

Në kuadër të *rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm* janë bërë përpjekje të sukseshme dhe konkrete, ku përmendim këto drejtime:

- *shpejtësia në hetime*: ka një përparim të dukshëm në procedimin me sukses me gjykime të drejtpërdrejta
- kujdesi me *masat e sigurimit* ka qenë maksimal, sipas nevojave të sigurimit, janë aplikuar masa alternative si garancia pasurore, detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore
- vazhdon të aplikohet në masë *pagesa e dënimit* (Neni 291 i K.Penal) duke përmirësuar kohën e gjyqimit, respektimin e qëllimit të dënimit dhe të drejtave të njeriut, si dhe duke siguruar praktikisht një nivel të konsiderueshëm të ardhurash për shtetin
- është përmirësuar ndjeshëm komunikimi dhe njoftimi për personat dhe institucionet

Rastet kur janë konstatuar mangësi në këtë aspekt lidhen me ngarkesën e punës, zgjerimin e komunikimeve ndërinstiucionale dhe kërkesat e shumëfishuara për informacion të paraqitura nga palë, persona, shoqata, institucione, në kuadrin dhe të ndryshimeve ligjore të viteve të fundit, por në kushtet e një personeli të kufizuar. Pavarësisht interesit pozitiv në shumë raste këto pengojnë ushtrimin e funksionit në një kohë sa më të arsyeshme, kur duhet pranuar se *ka patur një klimë jo tërësisht pozitive në kohët e fundit*, por që nuk ka arritur të ndikojë në veprimtarinë ligjore funksionale. Përpjekjet tona kanë qenë maksimale për korrektesë në komunikimet publike e ato të lidhura me procedimet konkrete, por shpresojmë që me plotësimin e mëtejshëm dhe kalimin e kësaj shtate tranzitore reformuese të arrihet të krijohet *një kuadër ligjor që do ta fokusonte prokurorin* veçanërisht në kryerjen e detyrave funksionale dhe krijimin e një *imazhi më të qartë të publikut* për atë ç'ka bën dhe duhet të bëjë ky institucion.

-II-

Në vitin 2017 ngarkesa në shifra është në nivele më të larta krahasuar me një vit më parë, por ngarkesa e punës praktikisht ka qenë dukshëm më e madhe, nisur dhe nga mangësitë në numër, ndërsa efektiviteti ka tendenca pozitive. Konkretisht vërejmë:


1. ka një numër të madh dosjesh me autor që është evidente duke parë tendencën në rritje në disa dispozita ku numri më i madh i çështjeve është me autor
2. numri i madh i vendimeve të mosfillimeve detyron vlerësimin në një kohë më të shkurtër për shkak të afatit të kufizuar
3. ka numër të madh të veprave penale me sanksione të konsiderueshme
4. numri i pushimeve ka tendenca rritjeje për shkak të kufizimit të afatit për mosfillimet
5. njoftimet dhe procedurat shpesh pengojnë ritmin e punës dhe rrisin kostot
6. problemet juridike krijojnë pengesa në vlerësimet dhe ndikojnë në kohën e punës dhe zgjidhjen e problemeve
7. efektiviteti ka qenë i mangët, pothuaj tërë vitin tre prokurorë dhe drejtuesi, administrata ka patur mangësi për shkak të lëvizjeve, ndërsa janë vetëm dy oficerë të policisë gjyqësore dhe shërbimet kanë përherë problemet e lëvizjeve
8. mbeten problem në vazhdimësi vjedhjet dhe dokumentimet pa vlera juridike penale

GJATË VITIT 2016:

Procedime	Mbartur	Gjykim	Pezullim	Pushime	Mosfillime
801	229	329	334	68	570

GJATË VITIT 2017:


Procedime	Mbartur	Gjykim	Pezullim	Pushime	Mosfillime
928	285	278	235	145	548



Treguesit vjetorë të krahasuar 2016-2017

Në një këndvështrim të përgjithshëm rezulton se veprat penale nga më të përhapurat kanë të njëjtën tendencë gjatë këtij viti:

1. disa vepra penale kanë rritje, disa janë të njëjtat nivele, por ka dhe rënie nga një vit më parë
2. ka rritje të konsiderueshme të numrit të çështjeve, ndërsa raportet në lidhje me efektivin janë tepër mbi normalen
3. mbeten problem vjedhjet (pa autor sidomos), posedimi etj. i narkotikëve, drejtimi i mjeteve në mënyrë të parregullt, kalimi i paligjshëm i kufirit
4. veprat që lidhen me *narkotikët* në vështrim të qartë nuk janë aq të përhapura (sidomos kultivimi) si në territorte të tjera të vendit; ka ulje të ndjeshme të kultivimit të narkotikëve, por mbetet problem evidentimi i autorëve ku ndikon dhe mënyra e administrimit të tokës dhe mangësitë pronësore; ka rritje të prodhimit, posedimit etj. të narkotikëve, ndoshta dhe territori afër kufirit e favorizon, ndërsa përdoret dhe kontigjenti i kalimit të paligjshëm të kufirit
5. ka rritje të dukshme të veprave dhe autorëve, ndërsa janë shtuar dhe rastet e hetimit për shpërdorimet e zyrtarëve,
6. ka tendencë në rritje *kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror*, situatë që lidhet me shumë faktorë pavarësisht përjekjeve tona dhe që në prespektivë të integritimit krijon probleme reale, po ashtu rastet e abuzimeve në drejtimin e mjeteve, ndërsa mbetet në nivele normale numri i aksidenteve me pasoja
7. ngarkesa krijon probleme për hetimet proaktive dhe ato kryesisht
8. procedura e re krijon impenjime shtesë që ndikojnë në cilësinë dhe sasinë e punës në vlerësimin efektiv




Tendencat për disa vepra penale 2016-2017


Më poshtë paraqitet përhapja e veprave penale në territor, të trajtuara gjatë vitit 2017, ku përfshihen çështjet e mosfilluara dhe ato të rregjistruara, sipas grupimeve në Kodin Penal ku kemi veçuar:

- Kreu II Vepra penale kundër personit, krime kundër jetës
- Kreu III Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike
- Kreu IV Vepra penale kundër mjedisit
- Kreu VIII Krime kundër autoritetit të shtetit
- Kreu IX Vepra penale kundër drejtësisë

VITI 2016



VITI 2017




-III-

Nga hetimet dhe vlerësimet konkrete rezultojn se dhe në territorin që mbulon kjo Prokurori rezultojn:

- është ndjerë dukuria e përhapur dhe aktuale për *veprat penale në fushën e narkotikëve*, sidomos tashmë posedimi etj., ndërkohë që mbetet problematike situata me vjedhjet
- *shkaqet e përhapjes* së tyre janë të ndryshme, sociale dhe ekonomike, probleme të infrastrukturës dhe edukimit të pamjaftueshëm në respektimin e rregullave e ligjeve, mosfunksionimi i rregullt i strukturave të ndryshme shtetërore që mbikqyrin veprimtari të palejuara dhe në shkelje të ligjit
- ka *tendencë në rritje*, madje është shqetësuese dhe krijon ngarkesë fiktive fakti se kallzohet për raste që nuk lidhen me veprimtarinë e organeve të ndjekjes penale, pasqyruar kjo dhe në vendimet e shumta të mosfillimit
- veprat penale dhe personat e hetuar e gjykuar kanë një *shpërndarje të drejtë në raport me shpërndarjen e popullsisë*, sipas numrit dhe territorit
- numri i të hetuarve *meshkuj* është dominant ashtu si dhe i personave të papunë, diferenca është më e vogël tek personat e dëmtuar
- numri i personave *përsëritës* është rritur, numri i të pandehurve dhe të gjykuarve, numri i masave të sigurimit përfshi arrestin në burg gjithashtu është rritur
- *arrestimet në flagrancë* janë në një masë më të madhe se ndalimet, në mënyrë të ndjeshme, ka udhëra ndalimi të prokurorit
- masat e sigurimit janë pranuar në shumicë nga gjykata që ka ulur ndjeshëm apelimet
- aplikimet e procedurave të reja kanë tregues pozitivë, si kërkesat në gjykatë, urdhërat penale, marrëveshjet etj.; ka dhe një praktikë pozitive në masat e sigurimit

Tendenca e kallzimeve dhe referimeve 2016-2017




-IV-

Në lidhje me *strukturën e legjislacionit penal dhe subjektet* vërejmë:

- raportet midis krimeve dhe kundërvajtjeve penale dominohen nga krimet
- raportet për vendbanimin e subjekteve, qytet-fshat, tregojnë rritje të implikimit të banorëve të zonave urbane, ndoshta për shkak të lëvizjeve demografike
- në lidhje me gjininë e subjekteve është qartësisht evidente epërsia e subjekteve meshkuj, sidoqë ka një numër të rritur subjektësh femra
- midis subjekteve kemi patur dhe shtetas të huaj
- niveli i ulët arsimor i subjekteve është gjithashtu evident
- pavarësisht nivelit më të lartë të veprave penale dhe autorëve në zonën rurale, ulja e kultivimit të narkotikëve dhe rritja e vjedhjeve në zonën urbane janë përcaktuese në raportet krahasuese
- dukuri e vecantë mbetet ”importimi i subjekteve”, pra tendenca e afrimit të kontingjentit kriminal nga jashtë territorit ku kemi kompetencën tokësore, për shkak të turizimit dhe kufirit
- mbetet shqetësues kategoria e përdoruesve të narkotikëve që kthehen lehtësisht në subjekte të veprave penale ndaj personit (në familje) dhe pasurisë
- subjektet e mitur nuk trajtohen nga ana jonë
- niveli i lartë i papunësisë dhe faktorët ekonomikë janë burim i rëndësishëm i një kategorie të gjerë subjektësh
- stina e verës krijon vepra dhe subjekte tej normales

Treguesit e subjekteve 2017





Gjatë vitit 2017:

- është proceduar me *masa sigurimi* mbi bazën e arrestimeve në flagrancë, ndalimeve me iniciativë nga policia gjyqësore, urdhërave të ndalimit të prokurorit
- është proceduar dhe me kërkesa direkte për masë sigurimi
- ka patur një rast për urdhërimin e lirimit të menjëhershëm
- arrestimet në flagrancë janë kryer më tepër për disa vepra penale: Nenet 130/a, 134, 283 e 291

Vlerësimet nga gjykata janë pozitive dhe pothuaj në masën më të madhe qëndrimet tona janë vlerësuar të ligjshme dhe masat e sigurimit janë pranuar nga gjykata, kjo dhe për faktin


se kemi vlerësuar me kujdes rastet dhe nevojat e sigurimit. Tendencë e dukshme ka qenë ndërhyrja e prokurorit që në momentet e para, ndaj dhe janë shmangur shumë vlerësime që mund të sillnin pasoja jopozitive në ecurinë e hetimit dhe gjyqimit.

Arrestet, ndalimet dhe masat e sigurimit 2016-2017



Në dënimet gjatë vitit 2017:

- ka patur një shpërndarje të drejtë ku dominojnë ato mesatare, duke vlerësuar rast pas rasti për arritjen e qëllimit të dënimit
- janë kërkuar dënime të rënda deri dhe maksimale
- vazhdon të aplikohet gjatë këtij viti në masë zëvendësimi i dënimit me burgim me pagesë mbi bazën e parashikimeve ligjore, në vazhdimësi të qëndrimit tonë, praktikisht e përkrahur dhe nga gjykata, me ndikim pozitiv jo vetëm në rehabilitimin e subjekteve, por dhe krijimin e të ardhurave për shtetin
- janë aplikuar dhe masa dënimi me gjobë të përshtatshme
- ka një rritje të personave përsëritës
- ndryshimet e reja kanë ndikuar në luhatje të politikës së dënimit.



Në vitin 2017 *çështjet e pushuara* kanë rritje për këto arsye:

- ulja e afatit për mosfillimet
- qëndrimi i përgjithshëm për vlerësimin më serioz të çështjeve
- rritja e pavarësisë së prokurorëve
- referimi i materialeve pa vlera juridike penale
- kallzimet formale të shtetasve
- rritja e nivelit të kallzimeve

Numri më i madh i çështjeve të pushuara është “*për mungesë fakti*” ku përfshihen si rastet kur është konstatuar se fakti nuk ekziston ashtu edhe ato kur fakti nuk përbën vepër penale. Pikërisht duke analizuar procedimet e pushuara për mungesë të faktit dhe të elementëve të veprës penale, konstatohet se ka qenë shumë i nevojshëm një proces verifikimi paraprak dhe një vlerësim më i drejtë i fakteve të paraqitura në materialin kallzues, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të evitohet rregjistrimi i procedimeve pa pasur bazën e mjaftueshme ligjore, do të respektohen liritë dhe të drejtat e shtetasve, por gradualisht mund të ulet dhe tendenca e kallzime që nuk lidhen me natyrën penale të fakteve. Çështjet e pushuara për mungesë të provave zënë një vend më të vogël çka tregon për përpjekjet e bëra për të provuar akuzat në ngarkim të personave ndaj të cilëve ushtrohet ndjekje penale, ndërsa ka dhe çështje të pushuara “*për shkaqe të tjera procedurale*” ku vendin kryesor e zënë ato që kanë të bëjnë me heqjen dorë nga ankimi prej të dëmtuarve për ato procedime ku ndjekja penale është e kushtëzuar nga vullneti i tij.

Në vitin 2017 janë *ankimuar* në Gjykatë vendime pushimi dhe mosfillimi të procedimit penal, nga të cilat për rastet konkrete kanë rinisur hetimet, por gjithsesi mbeten minorancë. Në këtë moment konstatojmë se Gjykata e Shkallës së Parë ka qenë më afër qëndrimeve tona, ndërsa ajo e Apelit mban qëndrim më të ndryshëm. Nga ana jonë mbetet që të thellohen më tej vlerësimet për këto raste dhe të ulet më tej numri i rasteve ku gjykata mban qëndrim të ndryshëm.

Duhet bërë më tepër për *çështjet kryesisht* dhe mendojmë se ka përmirësim, ndërsa ndryshimet e reja ligjore krijojnë më tepër hapësirë si për drejtuesin dhe për prokurorët që të vlerësojnë faktet për të cilat vijnë në dijeni në mënyra të ndryshme.

Gjatë vitit 2017 janë *pezulluar një numër i madh procedimesh penale*, por mbetet shqetësuese problematika e vjedhjeve. Ato zënë përsëri vendin kryesor, ndërsa ka rritje dhe për vepra të tjera, përfshi dhe ato të rënda penale. Vendimet e pezullimit janë marrë pasi janë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore duke i kushtuar rëndësi të veçantë kryerjes së veprimeve në vendin e ngjarjes, fiksimit të provave në formën e parashikuar në ligj, etj. Për këtë qëllim ka patur komunikim të përhershëm me oficerët e Seksioneve dhe Shërbimeve të Policisë Gjyqësore, si dhe drejtuesit e tyre për përmirësimin cilësor të kryerjes së veprimeve hetimore në fazën e hetimit paraprak.

Rezultate ka, por mbetet ende punë për të bërë. Numri i procedimeve penale të pezulluara mbetet ende i lartë, duhet pranuar se ka ende *mungesë profesionalizmi* nga oficerë të policisë gjyqësore të caktuar dhe se nuk ka një evidentim të qartë të kontigjentit kriminal. Ky fakt bën që shpeshherë të gjendemi të papërgatitur për të orientuar hetimin në ngjarjet kriminale dhe të mos arrijmë të identifikojmë autorët. Kjo kërkon medoemos një koordinim më të mirë të punës midis strukturave të policisë, por edhe ndërmjet prokurorëve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore.

Mbetet shqetësues dhe *lëvizja apo mangësitë në personelin e shërbimeve të policisë gjyqësore*. Në këtë kontekst është e nevojshme dhe rritja e rolit drejtues e kontrollues të prokurorit në hetimin paraprak, për më tepër në frymën e ndryshimeve të reja ligjore, duke parë në vazhdimësi ligjshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore nga ana e tyre dhe vlerësimin korrekt të veprimtarisë së tyre. Nga puna e mirë do të kemi më tepër rifillime të hetimeve me sukses për procedime të mëparshme, të pezulluara për moszbulim autori.

Në vitin 2017 janë *dërguar për gjykim një numër më i madh procedimesh penale*, duke zënë një pjesë të konsiderueshme në totalin e procedimeve penale. Treguesit e çështjeve të dërguara në gjyq janë në parametra tepër pozitivë duke ju përmbajtur gjithmonë parimit për të dërguar në gjyq ato procedime për të cilat ka pasur një bazë të mjaftueshme të dhënash hetimore paraprake për provueshmërinë e akuzës në ngarkim të personave të pandehur. Për *veprat penale të rënda* si: krimet kundër personit, pasurisë, por edhe për vepra të tjera të përhapura në territor hetimet ndaj autorëve të dërguar për gjykim janë ndjekur në gjendje arresti.


Gjatë vitit 2017 janë *hetuar e gjykuar me sukses* procedime për vepra të ndryshme penale si ato të korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës, vepra të rënda penale, por dhe mjaft procedime për veprat penale të organizimit të llotarive të palejuara, për fallsifikim të dokumenteve, vjedhje të pasurisë, shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, etj.

Nga procedimet e dërguara për gjykim pjesën kryesore e zënë procedimet e regjistruara mbi bazën e materialeve të referuara nga organet e Policisë së Shtetit si dhe nga qytetarët. Ka një vlerësim pozitiv të fakteve dhe kryesisht ka një qëndrim ka gjetur përkrahjen në vendimet gjyqësore, por dhe në fazën e ankimeve.

Në vitin 2017 kanë nisur gjykimet e para sipas Kodit të ndryshuar të Procedurës Penale, me efekte pozitive. Ka një përshtatje të mirë të prokuroëve dhe hapat e parë duken të suksesshëm në kërkesat dhe gjykimet e reja. Mbeten gjithashtu problematika të gjera në trajtimin dhe vlerësimin e situatave të reja procedurale, në kërkesat, gjykimet, fazën e ekzekutimeve etj. Ngarkesa tej asaj të punës normale të prokurorit në procesin e punës (kërkesat, njoftimet etj) ndikojnë shumë në shpejtësinë dhe kohën e veprimit.

Njoftimet janë problemi i ri i kërkesave në gjykatë dhe gjykimeve, situata sjell zvarritje dhe shpesh mosarritjen e qëllimit efektiv, mbetet të shihet ecuria në kohë. Ky territor përballet dhe me largime, lëvizje apo banime të shumta në shtetin grek duke ndikuar praktikisht në masë të madhe në gjetjen dhe njoftimin e personave.

Në apelimet rastet më të shumta janë ato nga të pandehurit, ku pothuaj në shumicën e rasteve paraqitet ankimi. Prokuroria e Apelit na ka mbështetur vazhdimisht dhe kemi një komunikim shumë të efektshëm, me rezultate shumë pozitive. Në cdo kohë ka patur korrektesë, gatishmëri të dyanshme dhe efekt pozitiv në kohë e cilësi.



Në vitin 2017 është vendosur *mosfillimi* për 548 procedime penale. Për të gjitha këto raste është treguar kujdesi i duhur që vendimi të merret pasi të jenë kryer verifikimet e nevojshme dhe brenda afatit të përcaktuar në urdhërin e Prokurorit të Përgjithshëm e më tej në ndryshimet ligjore procedurale. Përgjithësisht është respektuar ky afat me përjashtim të disa rasteve kur vonesat kanë ardhur për shkaqe objektive, siç është rasti i vonesave të akteve të ekspertimit, kryesisht mjeko-ligjore, por në raste të veçanta edhe për neglizhencë nga oficerët e policisë gjyqësore të ngarkuar për të kryer verifikimet apo edhe nga vetë prokurorët.

Mendojmë se politika e ndjekur në rastet e vendimeve të mosfillimit ka shërbyer jo vetëm për të mos harxhuar energji të panevojshme, por edhe për të parandaluar fillimin e ndjekjes penale ndaj personave të cilët në fakt nuk dyshohen të kenë kryer ndonjë vepër penale.


Në zbatim të detyrimeve të ligjit procedural penal të gjithë personave të interesuar u janë komunikuar vendimet e mosfillimit duke u dhënë atyre mundësinë për të ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatë. Jemi kujdesur madje dhe të rishohim dosjet në arshivë për të realizuar me efikasitet njoftimin dhe vënien në dispozicion të akteve personave të interesuar.

Mbetet tepër shqetësuese krijimi i një praktike, tashmë evidente, nga shërbimet e policisë gjyqësore, ku për shkak të pretendimeve të qytetarëve, në kushtet kur mosdokumentimi mund të krijojë idenë e moskryerjes së detyrës, thuhet detyrohet dokumentimi i një sërë *faktesh që nuk kanë lidhje me ato me natyrë penale*. Shpresojmë se ndryshimet e reja ligjore të japin një zgjidhje për këtë problem, i cili krijon jo vetëm ngarkesë fiktive, por pengon ushtrimin e funksioneve në kohë të arsyeshme dhe me efektivitet të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

-V-

Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore kanë përballuar një numër të konsiderueshëm rastesh, duke nisur që nga referimet nga policia gjyqësore, kallzimet dhe ankimet nga shtetasit, procedime apo kallzime të ardhura për kompetencë, përfaqësime në gjykimet me palë të dëmtuara, përfaqësime në gjykime me objekt në fushën e ekzekutimeve të vendimeve penale apo marrdhëniet me autoritetet e huaja, veçojmë këtu dhe marrdhëniet tepër korrekte e bashkëpunuese, në kohë maksimale me sektorët përkatës në Prokurorinë e Përgjithshme.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë gjatë kësaj periudhe kohore ka kryer edhe detyrimet procedurale në *fushën e ekzekutimit të vendimeve penale*. Gjatë vitit 2017 i ngarkuar me këtë detyrë ka qenë prokurori, z.Sali Hasa që ka urdhëruar ekzekutimin e shumë vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Ekzekutimi i vendimeve penale është orientuar sipas udhëzimeve nga Prokuroria e Përgjithshme, një prokuror i ngarkuar posacërisht, duke diferencuar për sa ka qenë e mundur ngarkesën dhe të tjerët që ekzekutojnë vendimet në fazën e hetimit. Ka patur një ecuri korrekte dhe brenda afateve të arsyeshme ligjore për ekzekutimin e vendimeve penale, ku nuk janë evidentuar probleme. Janë ndjekur rregullisht në gjykatë edhe ankimet e të dënuarve gjatë fazës së ekzekutimeve. Problem mbetet ende ekzekutimi i dënimeve me gjobë, por në ndonjë rast edhe për moskryerje të të gjithë përpjekjeve nga organet përmbartimore, ndërsa përfitimet e përhershme nga amnistia po e kthejnë këtë lloj dënimi pothuaj të paaritshëm shpesh në ekzekutim përfundimtar. Aktualisht ka nisur aplikimi i veprimit të secilit prokuror për ekzekutimin, por kjo krijon probleme në mënyrën e funksionimit dhe rakordimit.



Marrëdhëniet juridiksionale me jashtë janë realizuar më eficientë si dhe më lart kemi përmendur ku gjatë vitit 2017 janë përfunduar procedurat e ekstradimit për jashtë shtetit për të dënuar, rastet e njohjes së vendimeve penale të huaja, shpalljet në kërkim ndërkombëtar, por dhe njoftime të personave. Mbetet problem rakordimi kombëtar.

-VI-

TREGUESIT E PUNËS PËR VITIN 2017

Procedimet penale dhe materialet referuese që janë hetuar nga secili prej prokurorëve gjatë vitit 2017, janë si më poshtë:

Prokurori	Dërguar në gjyq	Pushuar	Pezulluar	Shpallur moskompetenca	Mosfillime
Edison Ademi	9	20	36	3	31
Sali Hasa	68	26	89	1	119
Lorenc Mërkuri	53	2	7	4	134
Elidon Hysenaj	12	1	6		
Ilir Hoxha	96	20	86	3	135

Drejtuessi i Prokurorisë është përpjekur të përmirësojë organizimin e brendshëm të punës dhe disiplinën e punës në Prokurori me qëllim rritjen e kontrollit ndaj punës së prokurorëve për procedimet penale që ata kanë në hetim dhe gjykim, por edhe duke marrë pjesë vetë aktivisht në rastet kur ka patur ngjarje të rënda kriminale dhe duke ndihmuar në zgjidhjen konkrete të tyre. Ai është zotuar personalisht duke trajtuar një numër të konsiderueshëm veprash penale. Në këtë kuadër i ka kushtuar një kujdes të veçantë trajtimin të të gjitha materialeve kallëzuese, regjistrimit të procedimeve penale, shpërndarjes së një ngarkese uniforme për të gjithë prokurorët, kontrollit gjatë fazës së hetimeve, kontrollit të çështjeve në momentin e përfundimit të tyre duke u kujdesur që vendimet e marra të jenë në përputhje me ligjin dhe për çështjet e dërguara në gjyq të zbatohet një politikë penale e unifikuar duke vlerësuar rrezikshmërinë e veprave penale dhe të autorëve, por edhe përhapjen e tyre në territorin ku Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm Sarandë ushtron funksionet e saj. Zëvendësimi i prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore është bërë vetëm në rastet e largimit të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore për shkaqe ligjore (janë në fakt raste të rralla), gjithnjë vetëm në interes e favor të ushtrimit të detyrave ligjore.

Në gjykimet është orientuar *një praktikë institucionale*, janë diskutuar vazhdimisht problemet konkrete dhe ecuria, ndërsa ka një bashkëpunim ligjor dhe raport në kohë shumë profesional dhe efikas me Prokurorinë e Apelit Gjykoakstër. Janë të rralla rastet kur nuk kemi patur të njëjtin mendim, por gjithnjë vetëm në situata tepër të diskutueshme juridike dhe duke patur në konsideratë dhe sjelljen në kohë të gjykatave. Gjithsesi, pavarësisht pretendimeve që mund të kemi për bazueshmërinë e vendimeve të gjykatës, duhet të merret në konsideratë në vazhdimësi qëndrimi i tyre për të bërë kujdes *në sigurimin dhe dokumentimin ligjor të provave në hetimin paraprak*, por edhe për rritjen e rolit të prokurorit gjatë shqyrtimit gjyqësor, sidomos në fazën e administrimit të provave. Për fazën e gjykimit i është kushtuar rëndësi sigurimit të provave të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë e të pandehurve si dhe diferencimit të llojit dhe masës së dënimit në varësi të veprës penale të kryer.

Për veprat penale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore, si ato kundër jetës dhe shëndetit, vjedhjet, mashtrimet, shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor, veprat penale në fushën e narkotikëve, etj. kërkesat tona për llojin dhe masën e dënimit kanë qenë të tilla që t'i shërbejnë parandalimit dhe ndëshkimit të këtyre veprave penale, por duke analizuar gjithë treguesit e këtij viti mendojmë se është gjithnjë e nevojshme që *politika e dënimit*, të jetë fleksibël me përparësitë ligjore dhe rekomandimet, duke u përmirësuar në vijimësi dhe duke u përshtatur me format dhe tendencat e kriminalitetit në territor dhe në raport me tendencat kombëtare.

Numri i *apeleve kundërshtues* ka qenë tepër minimal për shkaqe mendoj të bazuara dhe në raport me sjelljen dhe të gjykatës. Këto akte kanë pasur një ndikim pozitiv mbasi nuk kanë krijuar ngarkesa fiktive dhe ndikime në veprimtarinë gjyqësore, ndërsa në vazhdimësi politika e dënimit deri në formën e prerë ka qenë arsyeshëm pranë kërtimeve tona.

-VII-

Gjatë vitit 2017 vijoi *kryerja e detyrave në përputhje me ligjin* dhe udhëzimet përkatëse. Konstatohet se me gjithë problemet e vogla që janë hasur ka tendenca pozitive në përmirësimin e punës. Ka ardhur në përmirësim dhe kryerja e hetimeve paraprake nga oficerët e Shërbimeve të Policisë Gjyqësore, falë edhe kontakteve më të ngushta që janë vendosur mes tyre, prokurorëve dhe drejtuesit të prokurorisë. Është fakt që një numër i madh veprash penale janë hetuar nga oficerët e këtyre shërbimeve.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë është në nivele shumë të mira bashkëpunimi me shërbimet dhe drejtuesit, rrjedhojë e interesit të detyrës tonë të përbashkët për rezultate të arritura dhe ato që pretendojmë të arrijmë në të ardhmen.

Gjatë vitit 2017 nuk ka pasur raste që ndaj prokurorëve të jenë marrë *masa disiplinore*. Pavarësisht kësaj, duke trajtuar me shumë seriozitet shqetësimet e ngritura nga palët në proces apo qytetarët, është kërkuar në vazhdimësi që prokurorët të jenë korrekt me qytetarët, me vartësit, me kolegët, të ruajnë një figurë të pastër etiko-morale duke i shërbyer në radhë të parë vetes, por edhe ruajtjes së një imazhi të pastër të Institucionit. Këtij qëllimi

i ka shërbyer edhe transparenca e reflektuar me qytetarët, por edhe me median kur këto të fundit kanë shfaqur interes për çështje konkrete të veprimtarisë së organit. Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni nuk ka pasur procese disiplinore ndaj oficerëve të Policisë Gjyqësore. Organizmi dhe mbledhja e prokurorëve janë zhvilluar me seriozitet, me gjithë trupën e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore me tematikë të përcaktuar duke trajtuar problemet që kemi hasur në praktikën e përditshme.

Janë diskutuar dhe kanë nisur të aplikohen ndryshimet e reja ligjore dhe po ecet mirë në azhurnimet përkatëse ligjore, teknike dhe administrative.

Administrata ka punuar me seriozitet dhe puna e këtyre punonjësve ka qenë mbështetje e rëndësishme për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në ushtrim të detyrës së tyre, por edhe për qytetarët të cilëve u janë ofruar shërbime administrative të cilësisë së lartë, evidente kjo dhe në normalitetin e veprimtarisë sidomos në periudhat me ngarkesë të lartë pune dhe veprimtari institucionale. Drejtimet e përgjithshme janë në nivele të kënaqshme dhe në veprimtarinë financiare.

-VIII-

Nga analiza në tërësi e elementëve që u përmendën më lart, evidentojmë këto *problematika* duke propozuar marrjen në konsideratë për efektivitetin e punës dhe ushtrimit të funksionit:

- Nevojitet zgjidhje për kompetencën tokësore, në këtë kuadër dhe krijimi i një mekanizmi më eficient për rastet e moskompetencave
- Ngarkesa reale dhe ndryshimet ligjore kanë nevojë për përcaktim më të mirë të numrit të prokurorëve, konkretisht rritjen e tyre, stabilitet në vendin ku ushtrojnë funksionet (pa lëvizje), mbajtje në konsideratë e ngarkesës në periudhën e turizmit etj., mundësisht duke sjellë prokurorë apo oficerë të komanduar; në këtë kuadër duhet të vlerësohet dhe numri i administratës që është dukshëm i pamjaftueshëm, po ashtu shërbimet mbështetëse; në fund të fundit të zbatohen ndryshimet e reja ligjore për personelin
- Të gjendet një mekanizëm për referimet pa vlerë juridike penale dhe njoftimet
- Të ketë orientime lidhur me problematikat e shumta të zbatimit të legjislacionit të ri
- Të ndahet puna e prokurorit nga impenjimet që nuk lidhen me funksionin e tij (statistika, akses dhe plotësime në sistem etj.)
- Të ketë çdo prokuror akses në sistemet kombëtare (të gjendjes civile, TIMS etj.)
- Të merren masa për ripajisjen më armën të prokurorëve dhe sigurinë e tyre
- Të krijohet situata e nevojshme për një ushtrim normal të funksionit dhe të garantohet zbatimi i ligjit në procesin e rivlerësimit

Në këto kontekste përcaktojmë dhe *prioritetet tona* kryesore për të ardhmen:

- Krijimi i të gjitha kushteve për ecurinë normale të ushtrimit të funksionit duke qenë në koherencë të plotë dhe të përhershme me procesin ligjor në zhvillim, urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe çdo situatë tjetër që lidhet me

procesin e punës, pavarësisht vështirësive në boshllëqet ligjore aktuale dhe situatën e përgjithshme

- Ndjekja me përparësi e rasteve që kanë ecur me ngadalësi apo kanë efekt të rëndësishëm në funksionin dhe imazhin e institucionit
- Përfundimi në një kohë sa më të shpejtë, brenda tremujorit të parë të vitit 2017 të çështjeve të mbartura dhe arritja e niveleve maksimale të barazisë së ngarkesës, alternuar me procedurat për shortin
- Ndjekja me përparësi e procedimeve penale përveçat penale në tregues jo të mirë (vjedhja etj.); rritja e hetimeve kryesisht dhe proaktive
- Rritja e përpjekjeve nga prokurorët për të bërë të mundur rritjen e koeficientit të zbulueshmërisë së veprave penale; përmirësimi i treguesve gjyqësorë, cilësimit ligjor dhe politikës penale; Ndjekja në vazhdimësi e çështjeve për ngjarje kriminale të rënda të pezulluara në vitet e mëparshme, në bashkëpunim të ngushtë me shërbimet
- Rritja e funksionit drejtues dhe kontrollues të prokurorit në hetimet paraprake të kryera nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore dhe në frymën e ndryshimeve të reja ligjore; përmirësimi i organizimit, drejtimit dhe kontrollit brenda organit të Prokurorisë për t’ju përgjigjur në kohë dhe me cilësi kërkesave të luftës kundër kriminalitetit; respektimi i detyrimeve të ligjit procedural penal, urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm
- Rritja e profesionalizmit të prokurorëve dhe ruajtja e një figure morale të pastër jashtë çdo ndikimi.

DREJTUESI I PROKURORISË

EDISON ADEMI

Sarandë, 04.02.2018